



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14 Qershor 2021

Nr. 404

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të ankesës së qytetarit, për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Drejtorisë Rajonale Vlorë

Kërkues: Shtetasi z. Nebi Zeqaj

Ndaj: Drejtorisë Rajonale, Vlorë

Baza Ligjore: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 13.04.2021, protokolluar me nr. 3755 prot., datë 14.04.2021, është paraqitur ankesa e z. Nebi Zeqaj, i cili shprehet se prej 32 vitesh tashmë që ushtron profesionin e infermierit në Qendrën Shëndetësore, Qesarat, Tepelenë në mënyrë krejt të papritur, jashtë mundësive fizike të kërkuesit dhe në kundërshtim me vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me Urdhrin nr. 128, datë 06.04.2021 të Drejtorisë Rajonale Vlorë, është transferuar në Qendrën Shëndetësore Luftinjë, Tepelenë.



Zoti Zeqaj shprehet se urdhri i sipërcituar, është në kundërshtim të plotë me vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ dhe se në kushtet shëndetësore që ndodhet, pasi është invalid i grupit të katërt, e ka të pamundur lëvizjen e tij në Qendrën Shëndetësore, Luftinjë Tepelenë e cila ndodhet 50 km larg nga vendbanimi i tij.

Referuar përgjigjes së tij, ankuesi bën me dije se, edhe pse nuk është militant i asnjë subjekti politik, i lind e drejta të gjykojë se ky urdhër transferimi, është bërë për arsye politike dhe jo vetëm që nuk qëndron por mbi të gjitha është në shkelje ligjore flagrante të dispozitave në fuqi.

Kjo ankesë i është përcjellë gjithashtu për dijeni KQZ-së, me shkresën nr. 1352/1 prot., datë 16.04.2021 protokolluar me tonën me nr. 3929, datë 19.04.2021, edhe nga institucioni i Presidentit të Republikës, ku pas nismës së bërë publike prej këtij të fundit, ku u kërkohet qytetarëve të denonconin çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e krimeve elektorale gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, z. Zeqaj ka paraqitur gjithashtu ankesën e tij kundër Drejtorisë Rajonale Vlorë.

Bashkëlidhur ankesës, z. Zeqaj gjithashtu ka paraqitur:

1. Urdhërin nr. 128, datë 06.04.2021;
2. Vërtetimin për sëmundje të përgjithshme
3. Shkresë për njoftim për transferim
4. Shkresë nxjerje llogarie për sigurimet shoqërore
5. Kopje të librezës së punës.

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se “*Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi*”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht faktin nëse është apo jo organi publik kompetent, për shqyrtimin e tyre.

Juridiksioni dhe kompetenca janë parakushte procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie juridike procedurale e vlefshme.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:



- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Lidhur me këtë ankesë të zotit Zeqaj, i cili ka si objekt të tij “Shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se ky ankim është objekt shqyrtimi nga ana e tij.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues z. Zeqaj, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4989 prot., datë 06.05.2021, i ka kërkuar Drejtorisë Rajonale Vlorë, informacion sqarues lidhur me transferimin e shtetasit Zeqaj në Qendrën Shëndetësore, Luftinjë, Tepelenë si dhe argumentat e tyre për respektimin e kërkesave të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, në lidhje me urdhërin nr 128, datë 06.04.2021 të miratuar prej tyre.

Me shkresën nr. 1630/1 prot., datë 25.05.2021, administruar me tonën me nr. 4989 prot., datë 27.05.2021, Drejtori i Drejtorisë Rajonale Vlorë, z. Kujtim Llapi, ka kthyer përgjigje nëpërmjet së cilës bën me dije se: Në mbështetje dhe zbatim të:



1. VKM-së nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën dhe organizimit dhe funksionimit të operatorit të shërbimit të Kujdesit Shëndetësor”;
2. Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 ‘Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë’ i ndryshuar,
3. Urdhërit nr. 18, nr 321 prot., datë 17.01.2019 të MSHMS “Miratim i Rregullores së Brendshme të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”;
4. Urdhërit nr. 21 nr. 211 prot., datë 3.5.2019 “Për një mirëmenaxhim të burimeve njerëzore (staf mjekësor) në institucionet shëndetësore të kujdesit parësor”.

Z. Zeqaj u transferua për një mirëmenaxhim të burimeve njerëzore pasi në situatën e krijuar nga Covid 19, ndihmën në kohën e duhur dhe asistencën e nevojshme, e ofron me shpejt një profesionist tjetër i shkencave mjekësore duke konsideruar dhe situatën shëndetësore të infermierit z. Zeqaj ku bën pjesë tek invalidët e grupit të katërt. Gjithashtu sipas z. Llapi, QSH Luftinjë është një Qendër Shëndetësore ku prej disa vitesh shërbimi nuk ofrohet në ambulancë por në familje, ndryshe nga sa ndodh në QSH, Qesarat, e cila regjistron aktivitet më të lartë shëndetësor si rezultat shërbimit të ambulancës dhe numrit më të madh të banorëve. Duke marrë po ashtu në konsideratë gjëndjen e tij shëndetësore, z. Zeqaj i është lënë në ngarkim një përgjegjësi pune më e vogël krahasuar me atë në Qendrën Shëndetësore, Qesarat.

Sipas z. Llapi, ky transferim i kryer ndaj z. Zeqaj nuk është në kundërshtim të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, pasi ashtu sikurse dhe vetë pika d e nenit 3, parashikon, sipas tij, ky transferim është rast i përligjur dhe ka lindur si nevojë e domosdoshme për ofrimin e shërbimit në këtë situatë pandemie dhe fushatë vaksinimi.

III. Analiza ligjore

Neni 3, pika 1.3, shkronja “d” i vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë dhe ato veprimtari që përfshijnë:

“gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërimet provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet



kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.

Për sa më sipër, veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me **rastet e përligjura** të parashikuara në neni 3, pika 1.3, shkronja “d” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Referuar informacionit të përcjellë nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Vlorë, z. Kujtim Llapi, konstatohet se, transferimi i z. Zeqaj, është bërë si rrjedhojë e një sërë aktesh nënligjore të hyra në fuqi, përpara fushatës zgjedhore.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi e provuar se Drejtorja Rajonale Vlorë, është në shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga z. Nebi Zeqaj pasi në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se transferimi i z. Zeqaj, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:



V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Drejtorisë Rajonale, Vlorë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

